



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2024:168812

Datë: 10.01.2025

Numri i dokumentit: 06694449

C.nr.2474/24

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Sh.M nga Vushtrria, të cilën e përfaqëson K.F avokat nga Prishtina, rruga “...” 36/4, kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, me objekt kontesti pagesa mbi bazën e kualifikimit arsimor dhe kompensim mbi bazën e përvojës së punës, jashtë seance me datë 10.01.2025, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET së është tërhequr padia me numër C.nr.2474/24 e datës 05.06.2024, e paditëses Sh.M nga Vushtrria, kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, lidhur me çështjen kontestimore-pagesa mbi bazën e kualifikimit arsimor dhe kompensim mbi bazën e përvojës së punës.

A r s y e t i m

Paditësja Sh.M nga Vushtrria, të cilën e përfaqëson Av. K.F nga Prishtina, rruga “...” 36/4, me datë 05.06.2024, ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, për pagesën mbi bazën e kualifikimit arsimor dhe kompensim mbi bazën e përvojës së punës, në shumën prej 2,896.74 euro.

Përfaqësuesi i paditëses, me parashtrësën e datës 20.12.2024, e ka njoftuar gjykatën se shqyrtimi i mëtejme i padisë është i panevojshëm dhe i paarsyeshëm, andaj e tërheqë padinë në këtë çështje kontestimore.

Gjykata, në kuptim të dispozitave nga neni 261 e lidhur me nenin 387.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.2474/24, me datë 10.01.2025

Gj y q t a r i
Jeton Zymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.